



Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Rregullores nr. 03/2024 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

Titulli i pozitës së punës	Ofrues i Shërbimeve – Financier/e
Kohëzgjatja e emërimit	6 mujore
Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit	500.00 Euro
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	18.10.2024
Afati për aplikim	25.10.2024
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Departamenti	Departamenti i Koordinimit Rajonal
Divizioni	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 NSH Tregu
Vendi i punës	NSH “Tregu” – Tregjet e Prishtinës
Nr. i Referencës	18.10.2024 – OSH Financier/e

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ofruesi i shërbimeve caktohet në pozitën **Financier/e i/e tregjeve**;
- Menaxhimi i çështjeve financiare;
- Përfshirë përgatitjen e raporteve financiare dhe mbikëqyrjen e buxhetit të Ndërmarrjes;
- Përgatitja e raporteve të rregullta mbi performancën financiare të Ndërmarrjes, përfshirë bilancet;
- Llogaritjen e fitimit dhe humbjes;
- Raportet e fluksit të parasë;
- Paraqitja e raporteve të detajuara dhe analizave për autoritetin e likuidimit për të ndihmuar në marrjen e vendimeve strategjike;
- Regjistrimi dhe kontrolli i të gjitha transaksioneve financiare, përfshirë pagesat dhe të ardhurat, në sistemet e kontabilitetit;
- Sigurimi që llogaritë e Ndërmarrjes janë të balancuara dhe të sakta në përputhje me standardet e kontabilitetit;
- Kontrollimi dhe miratimi i shpenzimeve për të siguruar që ato janë të justifikueshme dhe të miratuara sipas politikave të Ndërmarrjes;
- Analiza e shpenzimeve dhe identifikimi i mundësive për optimizimin e kostove;
- Sigurimi i dokumentacionit të saktë dhe të plotë për të gjitha transaksionet financiare për qëllime raportimi dhe auditimi;
- Ruajtja e dokumenteve dhe raporteve financiare në përputhje me kërkesat ligjore dhe politikën e Ndërmarrjes;
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet financiare të jenë në përputhje me rregullat dhe normat ligjore dhe kontabël;
- Ndhomon në zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve të brendshme për të parandaluar abuzimet dhe gabimet financiare;



- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejt.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Të ketë të përfunduar Fakultetin Ekonomik

4. Kërkesa specifike

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi;
- Të ketë njohuri bazike në kontabilitet;

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se ka/nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

6. Mënyra e Aplikimit

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 25.10.2024 në ora 16:00 në emalin punesimi@pak-ks.org apo në Agjencinë Kosovare të Privatizimit - Zyra Rajonale të Prishtinës me adresë në Rr. "Dritan Hoxha", 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar

- Lista e kandidateve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 31.10.2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-